



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1819/3 Prot

Tiranë, më 30/12/2014

VENDIM

“Mbi pranimin e ankesës”

Nr. 01, datë 30/12/2014

Në mbështetje të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të nenit 31/1/a/c të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas shqyrtimit të ankesës së Z. , nr. 1819/1prot., datë 09.12.2014, kundër autoritetit publik/Komunës Kashar dhe Policisë së Komunës Kashar, me objekt “*Pajisjen me kopje të dokumenteve zyrtare/akt apo vendim*” dhe bazë ligjore nenin 11 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”;

V Ë R E N:

Nga shqyrtimi i ankesës së depozituar nga Z. rezulton se ajo është paraqitur brenda afatit ligjor, në përputhje me nenin 24/1/2/b të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Sipas kërkesës nr. 1819 prot., datë 19.12.2014, drejtuar autoritetit publik(AP)/Komunës Kashar dhe Policisë së Komunës Kashar- strukturë në varësi të kësaj komune, ankuesi pretendon se është cënuar në pronën e tij të cilën e disponon me çertifikatë pronësie. Konkretisht, *me datë 14.11.2014 punonjës të Komisarariatit të Policisë nr.6 në verifikim të një denoncimi si dhe pas marrjes së konfirmimit nga komuna për tokën si “pasazhkalimi” (sipas shkresës nr.2447/1prot, datë 10.11.2014) kanë ndërhyrë në pronën private të ankuesit duke hequr kufizimet e saj (zinxhirët e rrethimit), veprim i pasqyruar në procesverbalin e datës 14.11.2014.*

Nën këtë pretendim, ankuesi në cilësinë e kërkuarit ka kërkuar nga Komuna Kashar dhe Policia e kësaj komune, të pajiset me aktin përkatës mbi të cilin është ndërhyrë në pronën e tij. Në tejkallim të afatit të parashikuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” nuk rezulton që ankuesi Z. të jetë pajisur me informacion. Ky veprim rezulton të jetë kryer në kundërshtim me nenin 15/4 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në të cilin shprehimisht thuhet se “...Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës për informim brenda afateve do të konsiderohet refuzim”.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri bazuar në nenin 24/3 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ka kërkuar autoriteteteve publike që deri në datë 19.12.2014 të depozitojnë parashtrimet me shkrim mbi ankesën e paraqitur nga Z.

dhe njëkohësisht ka orientuar ato, të pajisin me përgjigjen përkatëse kërkuar, aktualisht në cilësinë e ankuesit pranë KDIMDP-së. Nga shqyrtimi i parashtrimeve të dërguara vetëm nga Komuna Kashar në datë 22.12.2014, rezulton të jenë dhënë shpjegime dhe të jenë bashkëngjitur prova të cilat në tërësi evidentojnë një situatë komplekse, përfshirë në të edhe procese gjyqësore të përfunduara apo të ndodhura në gjykime. Nuk evidentohet asnjë argument, shpjegim apo ndonjë akt mbi veprimin e kryer në pronën e ankuesit Z. Në parashtrime nuk pasqyrohen kundërshtime mbi pretendimet e ankuesit dhe as argumentohet mbi mos dhënien e

përgjigjes mbi informacionin/ dokumentacionin e kërkuar. Ndër të tjera, në parashtrime vërehet të citohet se pronar i pasurisë nr. 342/83 Vol 40 fq 141, ZK 3866 me sipërfaqe 180 m<sup>2</sup> sipas çertifikatës së pronësisë (*cituar në parashtrimet e AP*), nuk është pajisur me autorizim për rrethimin e saj dhe se kërkesa e tij për të kryer këtë veprim është refuzuar nga autoriteti publik. Komuna Kashar edhe pas kërkesës së bërë sipas shkresës nr. 1819/2prot., datë 17.12.2014 nga KDIMDP për të pajisur me informacion ankuesin në përmbushje të detyrimeve që njeh ligji për të drejtën e informimit dhe në përputhje me lejimet ose kufizimet e përcaktuara në të, nuk rezulton të ketë kryer këtë veprim për llogari të tij (ankuesit). Vlerësimi i dhënies së informacionit apo kufizimit të tij bëhet nga autoriteti publik në përputhje me nenin 17 të ligjit për të drejtën e informimit, por mos dhënia e përgjigjes mohon të drejtën e individit dhe është në kundërshtim të hapur me çdo parashikim ligjor dhe kur ajo bëhet e përsëritur rëndon pozitën e autoritetit publik. Cënimi i të drejtës për informim është një ndër të drejtat themelore më të rëndësishme për individin dhe shoqërinë në tërësi e parashikuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe garantimi i kësaj të drejte të shkelur siç është edhe rasti në fjalë, monitorohet dhe ndëshkohet nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në përputhje me ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Në aplikim të nenit 18/2/a të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, refuzimi i dhënies së informacionit është kundërvajtje administrative dhe si i tillë ky mosveprim nga ana e autoritetit, dënohet me gjobë nga 150.000 deri në 300.000 lekë. *Sanksioni administrativ në këtë rast i atribuohet koordinatorit për të drejtën e informimit*, në përputhje me nenin 19/3 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Në kushtet kur implementimi i ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkon hartimin e projekt/programave të transparencës nga autoritetet publike, brenda 6(gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e tij/nëntor 2014, Komisioneri vlerëson ndërmarrjen e masave më të shpejta dhe urdhërimin e zbatimit të detyrimeve ligjore ndaj individëve duke u rezervuar në ndëshkueshmëritë me gjobë vetëm në rastet e mos zbatimit të vendimit.

Në përfundim, në përsëritje të shkeljeve të konstatuara, më konkretisht për mos dhënie të informacionit ankuesit Z. \_\_\_\_\_, drejtuar Komunës Kashar dhe Policisë në varësi të kësaj komune, për mos dhënie të shpjegimeve në parashtrimet e autoritetit publik/Komunës Kashar në përputhje me objektin e ankesës si dhe nga shqyrtimi në tërësi i provave dhe bazueshmërisë ligjore, Komisioneri vlerëson se, ankesa e Z. \_\_\_\_\_ është e bazuar në ligj.

## PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenet 24/3/4, 24/5/b/ç të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar;

## V E N D O S A

1. Pranimin e ankesës nr. 1819/1, datë 9.12.2014 të Z. \_\_\_\_\_.
2. Urdhërimin e autoritetit publik/Komunës Kashar për të dhënë informacionin/ dokumentacionin e kërkuar, ankuesit \_\_\_\_\_, në përputhje me objektin e ankesës dhe ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, deri në datë 12.01.2015.

Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Vendimi i njoftohet menjëherë palëve.

Ky vendim u dha sot në datë 30.12.2014.

